

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues Afrim Shala, me sekretaren juridike Fikrete Destani, në çështjen penale ndaj të pandehurit I. O., nga ..., për shkak të dy veprave penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës¹ dhe veprës penale kultivimi i bimës së hashashit, shkures së kokainës ose bimëve të kanabisit, nga neni 278 paragrafi 1 të KPRK, të cilin sipas autorizimit e mbron avokatja T. Zh., nga ..., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.221/2015, e datës 3 mars 2016, të cilën e përfaqësonte prokurori Agron Uka, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 14 qershor 2016, më datën 17 qershor 2016, mori dhe publikisht shpalli, kurse, më datën 20 qershor 2016, e përpilojë me shkrim këtë :

AKTGJYKIM

I pandehuri I. O., nga babai H. dhe e nëna K., e lindur I., i lindur më ..., në K., tani me vendbanim në P., Lagjja e "...", rr."...", Hyrja ..., nr..., shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës, i martuar, babë i ... fëmiu, ka të kryer shkollën e ..., i gjendjes së varfër ekonomike, nuk ka qenë i dënuar më parë për vepra tjera penale,

ËSHTË FAJTOR

I.

Sepse me datën ... 2015, rreth orës , në ..., Komuna e K., me dashje dhe pa autorizim, ka poseduar me qëllim shitje substancë narkotike të llojit "...", e cila me ligj është shpallur si substancë e rrezikshme narkotike, i cili në

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20 prill 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

marrëveshje paraprake me një person me emrin B., nga K., Republika e Shqipërisë, i cili atë ditë gjersa ishte duke ndejtur në një kafiteri e ka vërejtur të pandehurin I., i ofrohet afër duke ia dhënë kuferin me substancë narkotike të llojit "...", në sasi prej ...gram, e cila ka qenë e paketuar në ... qese të plastikes, e përgatitur për shitje dhe shpërndaje tek personat e tjerë, i njëjti e merr kuferin, hyp në autobusë dhe në K. e takon të pandehurin I. S., ia jep kuferin me qëllim që ta mbaj, për shkak të disa obligimeve që ka pasur i pandehuri I. në P. dhe të kthehet që ta marr kuferin pas 3-4 ditë, e që bazuar në testin fushor ka rezultuar të jetë "...",

- me këtë ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 paragrafi 1 të KPRK.

II.

Sepse me datën ... 2015 rreth orës ..., në fshatin B., Komuna e K., pa autorizim, me dashje dhe me qëllim shitje dhe shpërndarje, ka poseduar substancë narkotike të llojit "...", ashtu që gjatë bastisjes nga zyrtarët policor, në objektin përcjellës-shtallë, është gjetur dhe sekuestruar sasia prej ... gram substancë narkotike e llojit "...",

- me këtë ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 paragrafi 1 të KPRK.

III.

Sepse në fshatin B., Komuna e K., pa autorizim dhe me qëllim të prodhimit të narkotikëve ose substancave psikotripe, ka kultivuar bimë narkotike të llojit "...", të cilat me datën ... 2015, gjatë kontrollit nga policia e Kosovës, në pronën e tij, objektin përcjellës-shtallë, nën kulme, janë gjetur ... kofa të mëdha në të cilat ka pasur të mbjella bimë "...", por në momentin e bastisjes janë gjetur vetëm ... bimë "...", të mbejllura në kofa të mëdha të cilat janë sekuestruar dhe shkatërruar nga ana e DTHN në Gjilan,

- kultivimi bimës së hashashit, shkurrese së kokainës ose bimëve të kanabisit, nga neni 278 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, kryetari i trupit gjykues, në bazë të dispozitave të lartcekura ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 45, 46, 62 paragrafi 2 nënparagrafi 6, 69, 73, 74, 75, 76, 80 dhe 83 të KPRK, si dhe nenit 247 dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit I. O., për veprën penale sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimit i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë)

muajve dhe dënimi me gjobë në shumë prej 600 € (gjashtëqind Euro); për veprën penale sipas dispozitivit II të këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe dënimi me gjobë në shumë prej 800 € (tetëqind Euro), kurse, për vepën penale sipas dispozitivit III të këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve.

Konform nenit 80 paragrafi 1 dhe 2 nëparagrafi 5 të KPRK, të pandehurit I. O., i shqiptohet

DËNIMI ME BURGIM DHE DËNIMI UNIK ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit I. O., i shqiptohet dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjetëve dhe dënimi unik me gjobë në shumë prej 1400 € (njëmijekatërqind Euro), të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë, dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzetë Euro) të dënimit me gjobë do të caktohet nga 1 (një) ditë burgim.

Ndaj të pandehurit I. O., ndërprehet masa e arrestit shtëpiak dhe i njejti duhet të lirohet më datën 17 qershor 2016.

Koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej datës 26 shkurt 2016 deri më datën 17 qershor 2016, të pandehurit do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim, në atë mënyrë që 1 (një) ditë paraburgim do të barazohet me 1 (një) ditë burgim.

Konfiskohet substanca narkotike e llojit "...", në peshë të përgjithshme prej ... gramëve, si dhe ...bimë "...".

Detyrohet i pandehuri I. O. që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 50 € (pesëdhjetë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

ARSYETIMI

1. Ecuria e procedurës

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, më 03 mars 2016 ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit I. O., nga ..., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 paragrafi 1 i KPRK dhe veprës penale kultivimi i bimës së ... shkurre së ... ose bimëve të ... nga neni 278 paragrafi 1 të KPRK.

Pas pranimit të aktakuzës, kryetari i trupit gjykues e ka caktuar shqyrtimin fillestar për datën 14 qershor 2016, ku është lexuar aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprat penale për të cilat akuzohet duke shtuar se e pranojë fajësinë për kryerjen e këtyre veprave penale.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit të pandehurit, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pas konsultimeve të mjaftueshme, me mbrojtësen e tij, avokaten e tij T. Zh. se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, kryetari i trupit gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- se i pandehuri I. O., me dashje i ka kryer veprat penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 paragrafi 1 i KPRK dhe vepra penale kultivimi i bimës së Hashashit shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278 paragrafi 1 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprave penale

Në nenin 273 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se formën themelore të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge e kryen “kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur

me ligj si narkotikë, substance psikotrope apo substanca analoge”, për të cilën është parashikuar dënim me gjobë dhe me burgim prej 2 (dy) deri në 8 (tetë) vjet. Kurse, në nenin 278 paragrafi 1 të KPRK është parashikuar se “kushdo që pa autorizim kultivon bimën e hashashit, shkurren e kokainës, ose bimën e kanabisit me qëllim të prodhimit të narkotikëve ose substancave psikotropike” dënohet me burgim prej 1 (një) deri në 10 (dhjetë) vjetë. Kryetari i trupit gjykues, e ka shpallur fajtor të pandehurin I. O., për shkak të veprave penale të lartcekura, ngase, veprimet e të pandehurit i përmbajnë elementet e këtyre veprave penale dhe për të njejtat është penalisht përgjegjës.

5. Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, kryetari i trupit gjykues ka vendosur që të pandehurin I. O., ta shpall fajtor për kryerjen e veprave penale sipas aktakuzës së lartcekur.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimeve

Me rastin e shqiptimit të dënimeve ndaj të pandehurit, kryetari i trupit gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 73, 74 dhe 75 të KPRK. Në këtë aspekt, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës kryetari i trupit gjykues e ka zbutur dënimin, pasi që e ka marrë parasysh mendimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit, është fakti se i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar. Kjo është një rrethanë e cila duke e ndërlidhur me rrethanat tjera të shënuara më poshtë, tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe i pandehuri me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale. Përveç kësaj, si rrethana tjera posaçërisht lehtësuese, kryetari i trupit gjykues i ka marrë për bazë edhe faktin se i pandehuri para kryetarit të trupit gjykues ka deklaruar se jam penduar thellë për kryerjen e këtyre veprave penale; sjelljet e mira të pandehurit gjatë shqyrtimit fillestar; faktin se sipas deklaratës së të pandehurit, të cilës kryetari i trupit gjykues ja ka falur besimin, i njëjti është i martuar është babë i një fëmiu; premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për vepra tjera penale. Gjithashtu, me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, kryetari i trupit gjykues e ka marrë për bazë edhe gjendjen pasurore të pandehurit.

7. Shqiptimi i dënimeve në harmoni me peshën e veprave penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së kryetarit të trupit gjykues, dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjetëve dhe dënimi unik me gjobë në shumë prej 1400 €

(njëmijekatërqind Euro) ndaj të pandehurit I. O., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Kryetari i trupit gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit

8. Zëvendësimi i dënimit me gjobë

Duke u bazuar në nenin 46 të KPRK, kryetari i trupit gjykues ka vendosur që nëse i pandehuri refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë, dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë, dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzetë Euro) të dënimit me gjobë do të caktohet nga 1 (një) ditë burgim.

9. Vendimi lidhur me arrestin shtëpiak

Kryetari i trupit gjykues, duke e bazuar në nenet 245 paragrafi 3 të KPP, ka vendosur që ndaj të pandehurit I. O., të ndërprehet masa e arrestit dhe i njejtë është liruar më datën 17 qershor 2016.

Ndërsa, duke u bazuar në nenin 83 të KPRK, kryetari i trupit gjykues, ka vendosur që koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës shkurt 2016 deri më datën ...qershor 2016, të pandehurit do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim, në atë mënyrë që 1 (një) ditë e qëndrimit në arrest shtëpiak do të barazohet me 1 (një) ditë burgim.

10. Dënimi plotësues

Përveç dënimeve kryesore, duke u bazuar në nenet 62, 69, 273 paragrafi 5 dhe 278 paragrafi 2 të KPRK, ndaj të pandehurit I. O., shqiptohet edhe dënimi plotësues marrja - konfiskimi i substancës narkotike e llojit "...", në peshë të përgjithshme prej ... gramëve, si dhe ... bimë "...".

11. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit, kryetari i trupit gjykues, duke u bazuar nën 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar vetëm paushallin gjyqësor në shumë prej 50 € (pesëdhjetë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Krimeve të Rënda
Më 20 qershor 2016

Sekretarja juridike,
Fikrete Destani

Kryetari i trupit gjykues,
Afrim Shala

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.